

THE SUPREME COURT OF KOSOVO  
PML-KZZ 111/15  
25 shkurt 2016

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Dariusz Sielicki, kryetar i kolegjit dhe gjyqtar raportues, gjyqtarja e EULEX-it Elka Filcheva-Ermenkova, dhe gjyqtari i Gjykatës Supreme Sylejman Nuredini, si anëtarë të kolegjit, të ndihmuar nga Adnan Isufi, këshilltar ligjor i EULEX-it, duke vepruar në cilësi të procesmbajtësit, në lëndën penale kundër të pandehurit:

HB

[REDACTED]

, në paraburgim prej 10 majit 2006.

I shpallur fajtor nga gjykata e shkallës së parë për kryerjen e veprave penale Vrasje e rëndë në shkelje të nenit 147 par. 1 pika 11 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së) dhe Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në shkelje të nenit 328 par. 2 të KPK-së, dhe i dënuar me dënim unik me njëzet e dy (22) vite burgim afatgjatë, të cilin pas ankesës së prokurorit dhe palës së dëmtuar, Gjykata Supreme e Kosovës e ka ndryshuar në dënim unik me njëzet e pesë (25) vite burgim duke llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim si pjesë të dënimit.

XHM

HB

Pas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga avokati mbrojtës [REDACTED] në emër të [REDACTED] kundër aktgjyqimit të lëshuar në shkallë të parë P. Nr. 605/2008 të datës 4 gusht 2010 dhe aktgjyqimit të Gjykatës Supreme të Kosovës AP 2/2011 të datës 25 maj 2012.



Pas shqyrtimit të mendimit të prokurorit publik të datës 15 qershor 2015.

Pas këshillimit dhe votimit më 25 shkurt 2015.

Duke vepruar sipas neneve 432, 433, 434 435 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (tani e tutje KPP), lëshon këtë:

**Aktgjykim**

- I. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga avokati mbrojtës [redacted] në emër të [redacted] kundër aktgjykimit të lëshuar nga gjykata e shkallës së parë P. Nr. 605/2008 të datës 4 gusht 2010 dhe aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës AP 2/2011 të datës 25 maj 2012, pranohet pjesërisht. Aktgjykimi i kundërshtuar i Gjykatës Supreme të Kosovës AP 2/2011 i datës 25 maj 2012, ndryshohet sa i përket vendimit mbi dënimin me ç' rast dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit [redacted] zvogëlohet në njëzet (20) vite burgim.
- II. Të gjitha pjesët e mbetura të aktgjykimit të kundërshtuar të Gjykatës Supreme të Kosovës mbeten në fuqi.


**ARSYETIM**

**I. Historia e procedurës**

1. Pas përfundimit hetimit, aktakuza është ngritur nga (ish)prokurori i Prokurorisë së Qarkut të Prishtinës më 3 gusht 2006 për kryerjen e pretenduar të veprës penale Vrasje e rëndë në shkelje të nenit 147 par. 1, pikës 11 të KPPK-së dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në shkelje të nenit 328 par. 2 të KPPK-së.
2. Prokurori pretendon se [redacted] pas një zënke lidhur me një parcelë të tokës e cila gjendet në rrugën kryesore Prishtinë-Mitrovicë, ka vrarë dy persona, [redacted] dhe [redacted]

AL

DL



3. Gjykimi ka filluar më 12 janar 2007, dhe më 22 korrik 2007 (ish) Gjykata e Qarkut në Prishtinë ka shpallur aktgjykimin. Gjykimi ka filluar më 12 janar 2007, dhe më 22 korrik 2007 (atëherë) Gjykata e Qarkut në Prishtinë ka shpallur aktgjykimin. Gjykata e shkallës së parë ka shpallur [REDAKTUAR] fajtor për tri vepra penale, përkatësisht dy pika të Vrasjes së rëndë në shkelje të nenit 147 par. 1, pikës 11 të KPPK-së dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në shkelje të nenit 328 par. 2 të KPPK-së, dhe i ka shqiptuar dënim unik me njëzet e dy (22) vite burgim

4. Më 22 qershor 2007, Gjykata Supreme e Kosovës ka pranuar ankesën e prokurorit dhe ankesën e avokatit mbrojtës të paraqitur në emër të [REDAKTUAR], ka anuluar aktgjykimin e kundërshtuar dhe ka kthyer lëndën në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.

5. Më 3 korrik 2009, pas kërkesës së mbrojtjes, Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it ia ka caktuar lëndën gjyqtarëve të EULEX-it të (ish) Gjykatës së Qarkut të Prishtinës.

6. Rigjykimi ka filluar më 3 dhjetor 2009, nga një trup gjykues i përzier i përbërë nga gjyqtarë të EULEX-it dhe gjyqtarë vendorë të (ish) Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.

7. Më 4 gusht 2010, pas përfundimit të rigjykimit, kryetari i trupit gjykues ka shpallur aktgjykimin. [REDAKTUAR] është shpallur fajtor për veprën penale Vrasje e rëndë në shkelje të nenit 147 par. 1, pikës 11 të KPPK-së dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në shkelje të nenit 328 par. 2 të KPPK-së. Ai është dënuar me njëzet e dy (22) vite burgim për Vrasje të rëndë dhe me një (1) vit burgim për Armëmbajtje. Sipas nenit 71 par. 1 dhe 2, pikës 1 të KPPK-së, [REDAKTUAR] i është shqiptuar dënim unik prej njëzet e dy (22) viteve burgim.

Hb



8. Më 20 prill 2011, Gjykata Supreme e Kosovës ka pranuar ankesat e (ish) prokurorit publik të Qarkut në Prishtinë dhe të palës së dëmtuar dhe ka ndryshuar aktgjykimin e kundërshtuar vetëm përkitazi me vendimin mbi dënimin. (HB) [redacted] është dënuar me njëzet e pesë (25) vite burgim për dy pika të Vrasjes së rëndë në shkelje të nenit 147 par. 1, pikës 11 të KPPK-së dhe me një (1) vit burgim për Mbjajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në shkelje të nenit 328 par. 2 të KPPK-së. Gjykata Supreme e Kosovës ka refuzuar ankesën e paraqitur nga avokati mbrojtës si të pabazuar.


9. Më 25 maj 2012, Gjykata Supreme e Kosovës refuzoi ankesën e paraqitur nga avokati mbrojtës në emër të [redacted] kundër aktgjyimit të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 20 prill 2011, si të pabazuar. (HB)

10. Avokati mbrojtës [redacted] (BS) ka paraqitur (HB) [redacted] kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në emër të [redacted] kundër aktgjyimit të (ish) Gjykatës së Qarkut të Prishtinës të datës 4 gusht 2010 dhe kundër aktgjyimit të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 25 maj 2012.

11. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ka paraqitur mendimin mbi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë duke i propozuar Gjykatës Supreme të Kosovës ta refuzojë kërkesën si të pabazuar.


## II. Parashtresat e palëve në procedurë

12. Avokati mbrojtës në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë pretendon në shkelje esenciale të dispozitave të kodit të procedurës penale të Kosovës dhe në shkelje të ligjit penal. Avokati mbrojtës i propozon Gjykatës Supreme të Kosovës ta pranojë kërkesën si të bazuar, t'i ndryshojë aktgjykimet e kundërshtuara dhe ta dënojë të pandehurin [redacted] për vrasje në rrethana të [redacted] të mbrojtjes së nevojshme. Përndryshe, nëse kërkesa nuk pranohet, avokati mbrojtës kërkon nga Gjykata Supreme të



ta ndryshoj vendimi mbi dënimin dhe të shqiptoj një dënim më të butë.

13. Avokati mbrojtës në veçanti pretendon se ka pasur shkelje të nenit 433 par 1 dhe 2 në lidhje me nenin 432 par 1 nënpar 1 dhe 2 dhe nenin 435 par 1 të KPP-së për shkak të vonesave në përpilimin e aktgjyqimit. Avokati mbrojtës më tutje pohon në shkelje të nenit 403 par 1 të KPP-së sepse kryetari i trupit gjykues ka shpallur aktgjykimin në mungesë të anëtarëve të trupit gjykues. Përveç kësaj, avokati mbrojtës thekson se gjykata nuk i ka marrë parasysh deklaratat e dëshmitarit [REDAKTUAR] i cili ka shpjeguar qartë se viktimat e kishin tërhequr zvarrë [REDAKTUAR] që si pasojë e ka sjellë atë në gjendje ku është detyruar ta përdorte armën për t'u mbrojtur. Avokati mbrojtës pretendon se janë plotësuar elementet e mbrojtjes së nevojshme ose të tejkalimit të mbrojtjes së nevojshme. (HB) (AT)
14. Avokati mbrojtës po ashtu thekson se çështjet që kanë të bëjnë me pronën për të cilën ka ndodhur konflikti tanimë janë zgjidhur në mes të dy familjeve pasi familja e [REDAKTUAR] e ka kompensuar vullnetarisht palën kundërshtare për pronën në pyetje. (HB)
15. Avokati mbrojtës pretendon se për shkak të këtyre shkeljeve, dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit nuk përputhet me veprën e kryer penale për shkak se rrethanat lehtësuese nuk janë vlerësuar drejt, veçmas, marrë parasysh se i pandehuri i ka pranuar veprat penale.
16. Në mendimin e tij, prokurori i propozon Gjykatës Supreme të Kosovës ta refuzojë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar. Prokurori parashtron se me kërkesë nuk është provuar si duhet asnjë gabim në aktgjykimet e kundërshtuara, i cili do të kërkonte anulimin apo ndryshimin e aktgjykimeve të kundërshtuara. Prokurori më tutje parashtron se gabimi i pretenduar të cilin e ka theksuar avokati mbrojtës nuk mund të cilësohet si shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, do të mund të paragjykonte ndjeshëm të drejtën e akuzuarit për gjykim të drejtë. (HB)




### III. GJETJET E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS


17. Në mënyrë që gjykata të jetë në gjendje ta shqyrtojë kërkesën e avokatit mbrojtës, është e domosdoshme që fillimisht të konstatohet se a janë plotësuar kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara në KPP.
18. Gjkata Supreme e Kosovës konstaton si në vijim:
- a. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmerisë është e pranueshme, është paraqitur pranë gjykatës kompetente në pajtim me nenin 434 dhe brenda afatit në pajtim me nenin 433 të KPP-së.
  - b. Gjkata Supreme e Kosovës ka vendosur në seancë siç është përcaktuar me nenin 435 të KPP-së.
  - c. Gjkata Supreme e Kosovës gjen se kërkesa është pjesërisht e bazuar.
19. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, kolegji gjen se aktgjykimet e apeluara nuk kërkojnë intervenim sipas detyrës zyrtare. Prandaj, kolegji kufizohet vetëm në shqyrtimin e atyre shkeljeve të ligjit të cilat paraqitësi i kërkesës i ka pretenduar në kërkesën e tij.

### III. GJETJET E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS

20. Gjatë adresimit të pretendimit të avokatit mbrojtës lidhur me mungesën e anëtarëve të trupit gjykues me rastin e shpalljes së aktgjykimit nga kryetari i trupit gjykues, Gjkata Supreme e Kosovës gjen se argumenti është pa meritë.



21. Neni 366 i KPP-së përcakton se "pasi gjykata merr aktgjykimin, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e shpall menjëherë". Dispozita ligjore i referohet rasteve të cilat gjykohen nga gjyqtari i vetëm gjykues dhe/ose nga trupi gjykues. Në të dy situatat, shpallja e aktgjykimit bëhet nga kryetari i trupit gjykues. Dispozita nuk e shpreh në mënyrë eksplicite se anëtarët e trupit gjykues duhet patjetër, edhe pse është e këshillueshme, të jenë të pranishëm gjatë shpalljes së aktgjykimit.
22. Në këtë rast aktgjykimi është marrë në kolegjum, përkatësisht nga trupi gjykues i përbërë nga kryetari i trupit gjykues dhe dy anëtarë të trupit gjykues. Avokati mbrojtës nuk pretendon se aktgjykimi i marrë nuk është i njëjtë me atë të shpallur nga kryetari i trupit gjykues. Pretendimi i avokatit mbrojtës është se mungesa e anëtarëve të trupit gjykues me rastin e shpalljes së aktgjykimit në vetvete përbën shkelje substanciale të procedurës penale.
23. Kolegji gjen se neni 366 nuk e kërkon praninë e anëtarëve të trupit gjykues gjatë shpalljes së aktgjykimit. Nuk ka asnjë pretendim nga avokati mbrojtës në lidhje me përmbajtjen e aktgjykimit me shkrim. Prandaj, kolegji konstaton se vetëm fakti se anëtarët e trupit gjykues nuk ishin të pranishëm gjatë shpalljes së aktgjykimit nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore të KPP-së.
24. Lidhur me vonesat në përpilimin e aktgjykimit, neni 369 i KPP-së përcakton se "aktgjykimi i shpallur duhet të përpilohet me shkrim brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga shpallja e tij, kur i akuzuari gjendet në paraburgim ose i është caktuar paraburgimi, ndërsa në raste të tjera brenda tridhet (30) ditëve nga dita e shpalljes". Kur rasti është i ndërlikuar, ky afat, përjashtimisht, mund të zgjatet nga Kryetari i gjykatës përkatëse me kërkesë të kryetarit të trupit gjykues deri në gjashtëdhjetë (60) ditë.
25. Kolegji pajtohet me avokatin mbrojtës se aktgjykimi në këtë lëndë nuk është përpiluar me shkrim dhe nuk është dorëzuar palëve në procedurë brenda afatit të përcaktuar me ligj sipas nenit 369 të KPP-së. Sidoqoftë, sipas



mendimit të kolegjit dështimi për t'iu përmbajtur dispozitës së përmendur nuk përbën shkelje esenciale e cila si e tillë do ta bënte aktgjykimin të pavlefshëm/ ose do të kërkonte anulimin e tij, përderisa procedura në përgjithësi, shikuar në tërësinë e saj, është zhvilluar në atë mënyrë që i pandehurit ka pasur një gjykim të drejtë. Për më tepër, kolegji vëren se KPP-ja, në fakt nuk përmban asnjë sanksionim për mosrespektimin e afatit.

26. Kolegji gjen se procedura në përgjithësi në këtë lëndë është zhvilluar brenda afatit të arsyeshëm, duke pasur parasysh natyrën e akuzave kundër të pandehurit dhe faktin se ai është dënuar me burgim afatgjatë. Fakti i vonesave evidente në dorëzimin e aktgjykimit me shkrim, në vetvete nuk paraqet një pretendim të argumentueshëm për shkelje substanciale të të drejtave të pandehurit të mbrojtura me ligjet e aplikueshme. Gjykata nuk ka gjetur se kjo shkelje përbën shkelje të ligjit.
27. Gjatë shqyrtimit të pretendimit të avokatit mbrojtës në lidhje me mbrojtjen e nevojshme, ose tejkallimit të mbrojtjes së nevojshme, Gjykata Supreme ka gjetur se ky argument është pa meritë.
28. Kolegji e konsideron të rëndësishme të theksohet se mbrojtja e nevojshme ekziston atëherë kur personi kryen aktin për të zbrapsur sulmin e kundërligjshëm, real dhe të atëçastshëm ndaj vetes ose personit tjetër me kusht që karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me shkallën e rrezikut që paraqet sulmi. Kur akti është në disproporcion me shkallën e rrezikut që paraqet sulmi, konsiderohet se akti ka tejkalluar kufijtë e mbrojtjes së nevojshme.
29. Gjatë adresimit të pretendimeve për mbrojtje të nevojshme dhe tejkallim të mbrojtjes së nevojshme, Gjykata Supreme është e mendimit se gjykatat paraprake kanë dhënë arsyetim të mjaftueshëm dhe të drejtë me të cilin ky kolegji pajtohet plotësisht, se nuk ekziston asnjë provë se i pandehuri ka vepruar në mbrojtje të nevojshme apo ka tejkalluar mbrojtjen e nevojshme. Siç është vërtetuar nga gjykata e faktit, nuk ka asnjë provë e cila vërtetohet ekzistuar një sulm i atëçastshëm nga viktimat.





qenë i rrezikshëm për jetën e të pandehurit. Viktimat e kanë tërhequr të pandehurin nga ara deri në rrugë dhe e kishin lënë aty. Pas kësaj, i pandehuri ka shtënë mbi viktimat nga një distancë prej 6,30-7 m. Prandaj, kolegji gjen se argumentet e avokatit mbrojtës janë pa mëritë.

30. Lidhur me vendimin mbi dënimin, Gjykata Supreme konsideron se gjykatat e shkallëve më të ulëta kanë dështuar në vlerësimin në mënyrë të shteruar të rrethanave lehtësuese në përputhje me ligjin. Kolegji e konsideron të rëndësishme të theksojë se krimet që i janë atribuar të pandehurit nuk janë kryer nën rrethana veçanërisht të rënduara. Elementi i vetëm i cili cilëson akuzën për vrasje në formë të kualifikuar është numri i personave të privuar nga jeta. Kodi Penal përcakton se kur dy persona privohen nga jeta, pavarësisht nga rrethanat në të cilat është kryer krimi, ajo do të cilësohet si vrasje e rëndë. Sidoqoftë, sipas mendimit të kolegjit, duhet të bëhet një dallim në mes të rasteve ku veprat penale janë cilësuar si të rënda për shkak të kësaj dispozite ligjore dhe rasteve në të cilat nuk ka faktorë rëndues të pranishëm. Në këtë lëndë, përveç faktit se dy persona janë privuar nga jeta siç është vërejtur më lart që është element i vrasjes së rëndë, vetë krimi nuk përmban asnjë element i cili do të mund të konsiderohej si element plotësues rëndues.

31. Gjykata Supreme gjen se dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së dytë ka qenë i ashpër për arsyet në vijim: mungesës së faktorëve rëndues; shkalla e faktorëve lehtësues, përkatësisht, karakteri i të pandehurit më parë, shprehja e pendimit dhe në veçanti fakti se i pandehuri është provokuar nga viktimat të cilët, siç është vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë e kanë tërheqë të pandehurin zvarrë nga ara të cilën ai konsideronte se ishte e tij. Gjykata ka marrë në konsideratë se viktimat në këtë rast nuk kanë treguar fare respekt ndaj të pandehurit. Veprimet e viktimave, tërheqja zvarrë e të pandehurit nga ara, në rrethanat e lëndës, mund të konsiderohen si provokuese dhe tejet shqetësuese.

32. Në dritën e kësaj, Gjykata Supreme gjen se dënimi për krimin në fjalë është i ashpër për arsyet në vijim: njezet e pesë (25) viteve burgim i shqiptuar



shkallës së dytë është i ashpër dhe në vend të tij shqipton dënimin prej njëzet (20) viteve burgim. Në këtë dënim është llogaritur koha e cila tashmë është kaluar në paraburgim.

33. Gjatë shqiptimit të këtij dënimi, Gjykata Supreme ka marrë parasysh dënimet tjera të shqiptuara nga gjykatat për të njëjtat vepra në bazë të fakteve të ngjashme. Gjykata Supreme ka marrë në konsideratë nevojën për konsistencë gjatë dënimit dhe nevojën për të pasur parasysh rolin e gjykatave të shkallës së parë në adresimin e shqetësimeve dhe qëndrimeve të komunitetit lokal.

#### IV. KONSTATIMI I GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS:

Për arsyet e përmendura më lart, Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Supreme e Kosovës

PML-KZZ 111/15, më 25 shkurt 2016

Kryetar i kolegjit:

Procesmbajtës:

\_\_\_\_\_

Dariusz Sielicki

\_\_\_\_\_

Adnan Isufi

Gjyqtar i EULEX-it

Këshilltar ligjor i EULEX-it

Anëtarët e kolegjit:

\_\_\_\_\_


Elka Filcheva-Enri

\_\_\_\_\_

Sulejman Nuredini

Gjyqtare e EULEX-it

Gjyqtar i Gjykatës Supreme



SAKTESINË E KOPJËS E VERTETËN  
TË KËMBËST OTPRAVKA POTVRDUJE

Punëtori i autorizues  
Ovlašćeni radnik

*[Handwritten signature]*